



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SHK.II.nr.1706/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “NSHT Viktory Com” me seli në Bec 80 në Radoniq të Gjakovës kundër debitorit “Komuna e Klinës” me seli në rrugën Abedin Rexha nr. 31 në Klinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2614/2022 i datës 31.10.2023, me datë 07.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit “NSHT Viktory Com” me seli në Bec 80 në Radoniq të Gjakovës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2614/2022 i datës 31.10.2023 **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2614/2022 i datës 31.10.2023 e ka pranuar në tërësi prapësimin e debitorit të përmbarimit “Komuna e Klinës” me seli në Klinë, dhe e ka anuluar në tërësi urdhri përmbarimor P.nr.392/2021 i datës 01.07.2021 i përmbaruesit privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë dhe e ka përfunduar në tërësi procedura përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori “NSHT Viktory Com” me seli në Bec 80 në Radoniq të Gjakovës, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e kreditorit dhe të anulohet si i kundërligjshëm aktvendimi KPPP.nr.2614/22 i datës 31.10.2023, ashtu që lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje meritore, ashtu që të detyrohet debitorit që kreditorit t’ia paguaj shpenzimet procedurale dhe shpenzimet e avokatit konform TOA-së.

Përgjigje në ankesa ka parashtruar debitori “Komuna e Klinës” me seli në rrugën Abedin Rexha nr. 31 në Klinë, me të cilin ka kërkuar që të refuzohet në tërësi si të pa bazuar ankesa e kreditorit , duke e lënë në fuqi si të drejt dhe të ligjshëm, më të cilin e ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.392/21 të datës 01.07.2021.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Kreditori i përmbartimit “NSHT Viktory Com” me seli në Prishtinë më 01.07.2021 ka parashtruar propozim për përmbartim në zyrën e përmbartuesit privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori i përmbartimit “Komuna e Klinës” me seli në Klinë që t’ia paguaj shumën prej 12,603.51€ me kamatëvonesë vjetore prej 8% dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore. Propozimin për përmbartim e kishte bazuar në faturën nr. 001-10 të datës 19.12.2018 të lëshuara nga ai për Debitorin, të cilën në origjinal ia ka bashkëngjitur Propozimit. Gjithashtu, së bashku me Propozim e kishte dorëzuar një listë me shërbimet e kryera të nënshkruar dhe vulosur vetëm nga ai dhe raportin e përmbledhjes së punimeve në kontratën mes palëve në këtë procedurë të lëshuar nga Zyra për Arkitekturë e komunës së Klinës për DSHPE të komunës së Klinës më 24.12.2018, Përmbartuesi më 01.07.2021 e ka nxjerrë urdhrin përmbartimor P.nr.392/2021 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbartimin sipas Propozimit.

Debitori më 19.07.2021 ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj atë. Ai ka pretenduar se fatura lëndore nuk faqja 2 nga 3 është dërguar në mënyrë të rregullt dhe nuk është e pranuar nga ai. Më tutje ka shtuar se fatura lëndore nuk e ka as vendin e nënshkrimit të pranimit e as nënshkrimit. Përveç kësaj, ai pretenduar se fatura lëndore nuk e përmban kohën e kryerjes së shërbimeve-punimeve, kohën e përmbushjes së detyrimeve. Për më tepër është shprehur se Përmbartuesi është i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë e jo për territorin e Gjykatës Themelore në Pejë, prandaj ai nuk është kompetent për përmbartim në territorin e komunës së Klinës. Më tutje e ka sqaruar krijimin dhe zhvillimin e marrëdhënies juridike ndërmjet tij dhe Kreditorit, duke elaboruar zhvillimin e punimeve të Kreditorit. Prapësimi i ka bashkëngjitur disa kërkesa e vendime të tija lidhur shërbimet që i ka kryer Kreditori, ndërsa nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e Prapësimi.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në Prapësim.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së dytë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, të ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2614/2022 i datës 31.10.2023 e ka pranuar në tërësi prapësimin e debitorit të përmbartimit “Komuna e Klinës” me seli në Klinë, dhe e ka anuluar në tërësi urdhri përmbartimor P.nr.392/2021 i datës 01.07.2021 i përmbartuesit privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë dhe e ka përfunduar në tërësi procedura përmbartimore, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se dokumenti përmbartimor i cili është propozuar për përmbartim në bazë të faturës me Nr.001-10 të datës 19.12.2018, për shumën në vlerën prej 12,603.51€, nuk i përmban të gjitha elementet e një dokumenti përmbartimor, pasi që në faturë nuk gjendet as nënshkrimi e as vula e debitorit, dhe si e tillë nuk mund të jetë dokument i përshtatshëm për përmbartim në këtë procedurë. Prandaj, gjykata e shkallës së parë në rastin

konkret, ka vendosur duke u bazuar në dispozitat e nenin 29 par.3, 71, 73 par.1 të LPP –së duke e aprovuar prapësimin e debitorit dhe duke e përfunduar në tërësi procedurën përmbartimore.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimin të debitorit. Fillimisht propozimin për përmbartim është ushtruar në bazë të faturës Nr.001-10 të datës 19.12.2018, për shumën në vlerën prej 12,603.51€, e cila nuk i përmbanë tiparet e një fature të rregullt dhe nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm në procedurë përmbartimore, pasi me Nenin 29 të LPP-së, paragrafi. 1 nënparagrafi. 3 përcaktohet se me “*Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është (...) 1.3 faturat*” ndërsa në para. 3 përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar*”. Prandaj, Nga këto dispozita rrjedhë se, përmbartimi mund të fillohet edhe në bazë të faturës si dokument i besueshëm dhe se për ta caktuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, ai duhet ta ketë përmbartjen e kërkuar ligjore. Në rastin konkret, fatura lëndore nuk i përmban të gjitha elementet e kërkuara me dispozitat në fuqi të përcaktuara sipas LPP-së.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se faturat si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat përmbajnë vetëm të dhënat e kreditori dhe debitorit, objektin, llojin, shumën, mirëpo fatura nuk përmban as nënshkrimin e as vulën e debitorit. Prandaj, kjo e metë paraqet pengese për përshtatshmërinë për përmbartim të dokumentit të besueshëm, siç parashihet me nenin 71 par.1 nën par.1.1 të LPP-së.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë duke shqyrtuar pretendimet ankimore të kreditorit, të njëjtat i vlerëson si të pabazuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se prapësimi nuk është i bazuar dhe nuk përmban asnjë nga shkaqet e përcaktuara me nenin 71 të LPP-së, ngase fatura në bazë të së cilës është lëshuar Urdhri Përmbartimor, nuk mund të trajtohet si dokument i besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së, si dhe përmban të gjitha të gjitha elementet e kërkuara nga dispozita e lartcekur. Me nenin 29 par.1 pika 1.3 të LPP përcaktohet se “*1. Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.3. faturat*”. Ndërsa në paragrafin 3 të njëjtin nen përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar*”. Po ashtu, me nenin 37 dhe 40 par.1

pika 3 i LPP-së, përcaktohet se propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë *“origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit të besueshëm, ndërsa në rastin konkret edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate faturat e lartcekur nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm.*

Duke u mbështetur në nenin 69 par.4 të LPP *“baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”,* Gjykata vlerëson se ankesa e kreditorit është e pathemeltë pasi që kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë për të vërtetuar pretendimet e veta, për vendosjen ndryshe.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore të kreditorit të paraqitura në ankese, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara dhe të pa mbështetura në shkresat e lëndës, sepse dokumenti në bazë të së cilit është kërkuar përmbarimi nuk është i përshtatshme për përmbarim.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.SHK.II.nr.1706/23 dt. 07.02.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi